



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 7 MARS 2019**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 7. MARTA 2019. GODINE**

**MARS - MART  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Miratimi i rezolutës në lidhje me vëllezërit Bytyçi,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit,
11. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të Procedurës Penale,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Diasporën,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pronën publike,
17. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike,
18. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247,
19. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mosçaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës,
20. Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP-Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës Sh. A/NKEC.

## Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Usvajanje rezolucije u vezi sa braćom Bytyçi,
5. Drugo razmatranje N/zakona o Specijalizovanom veću Vrhovnog suda u vezi pitanja Kosovke agencije za privatizaciju,
6. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 2004/22 o kinematografiji,
7. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 04/L-065 o autorskim pravima i srodnim pravima,
8. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 04/L-097 o bibliotekama,
9. Drugo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakonika o krivičnom postupku Republike Kosova,
10. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 05/L-042 o regulisanju usluga vode,
11. Prvo razmatranje N/ zakonika o krivičnom postupku,
12. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona o ličnoj karti,
13. Prvo razmatranje N/zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
14. Prvo razmatranje N/zakona o Dijaspori,
15. Prvo razmatranje N/zakona o rada,
16. Prvo razmatranje N/zakona o javnoj svojini,
17. Prvo razmatranje N/zakona o jakim alkoholnim pićima,
18. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br. 04/L-061 o prodaji stanova za koje postoji stanarsko pravo, izmenjen i dopunjen zakonom br. 04/L-247,
19. Interpelacija premijera Republike Kosovo, Ramush Haradinaj, na zahtev PG PSD, u vezi neutvrđivanja i povećanja minimalne plate u Republici Kosovo,
20. Interpelacija ministra za ekonomski razvoj g. Valdrin Lluka, na zahtev predsednika PG- PSD g. Dardan Sejdiu, uz podršku 11 poslanika, u vezi osnivanja Novog energetskeg preduzeća Kosova A.D./NKEC.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 1 mars 2019. Procedojmë.

Memli Krasniqi, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Duke u nisur edhe nga zhvillimet e ditës e sotme dhe në seancën e kaluar, në koordinim me kolegët e grupeve parlamentare nga AAK, PSD, Nisma dhe Grupi 6+, për këtë seancë të rregullt ne kemi një propozim. Bazuar në nenin 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, një mocion për plotësimin e rendit të ditës të kësaj seance plenare që e kemi dorëzuar edhe me shkrim tashmë në sekretari. Propozojmë që tri pika e para të seancës të hiqen, edhe ashtu te pyetjet parlamentare nuk i kemi një pjesë të mirë të ministrave, dhe të plotësohet ky rend i ditës, duke filluar me pikën:

*1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë,*

*2. Votimi i Platformës për Dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikë së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.*

Arsyeja dhe nga ajo që thatë është që dëshira e të gjithëve ka qenë që fillimisht të votohet projektligji e pastaj platforma.

Dhe, propozojmë që pastaj në pikat vijuese të shkojmë me votim të pikave të papërfunduara nga seancat e mëparshme dhe atë nga seanca e mbajtur më 28 shkurt:

*3. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës të paluajtshme të Komunës,*

*4. Votimi në lexim të dytë Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-090 për sponsorizimin në fushën e kulturës, rinisë, sportit,*

*5. Votimi në lexim të Projektligjit për ndryshim-plotësimin e Ligjit 2003/24 Ligji i sportit, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-075 për ndryshim-plotësim të Ligjit 2003/24 për sport,*

6. *Votimi në lexim të dytë Projektligji për ndryshim-plotësim ligjit 05/L-075 për parandalim dhe sanksionim të dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive,*
7. *Votimi në lexim të dytë Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës,*
8. *Votimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore,*
9. *Votimi për emërimin e kryesuesit dhe të një anëtari të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit*
10. *Votimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,*
11. *Votimi i kryesuesit të Komisionit për mbikëqyrjen e Agjencisë të Kosovës për Inteligjencë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PSD-së,*
12. *Votimi në lexim të dytë i Projektligji për tatim në të ardhura personale,*
13. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
14. *Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhim të Komplekseve Memoriale në vitin 2017,*
15. *Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare,*
16. *Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat të Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi,*
17. *Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,*
18. *Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,*
19. *Votimi për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,*
20. *Votimi për shkarkimin e një anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.*

Pastaj me pikat e papërfunduara nga seanca plenare e datës 30 janar:

21. *Votimi i vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthim të Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare,*

22. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës,*

23. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,*

24. *Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave,*

25. *Votimi në parim i Projektligjit për peticione,*

26. *Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,*

27. *Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,*

28. *Votimi në parim i Projektligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar,*

29. *Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të zgjedhurve,*

Dhe pika e fundit e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme e datës 8 shkurt:

30. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës.*

E pastaj të vazhdohet me pikat nga katër deri në fund. Faleminderit!

Kërkoj vetëm sa për sqarim, meqenëse kemi të bëjmë me mocion procedural dhe shmangie të rasti i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, kërkoj që të merret parasysh që duhet të jenë së paku dy të tretat në mënyrë që ky propozim apo ky mocion të jetë valid. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! E dëgjuat propozimin e mocionin procedural të kryetarit të GP të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Memli Krasniqi. A jeni ta fusim në votim. Është mocion procedural. Zoti Hoti, urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Mendoj që duhet ta caktojmë një kohë kur deputetë vijnë në sallë, sepse seanca para pesë minutave fillon dhe nuk mund të pritet që deputetët të jenë në sallë në seancën e re me një njoftim prej pesë minutave. Unë mendoj që duhet të ketë së paku gjysmë ore njoftim që fillon seanca e re, sepse kjo seancë ka qenë e caktuar të mbahet në orën 10:00. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në fakt, gjithë opinioni publik është i pranishëm, jam duke i thirrur për aq sa po mundem çdo herë. Deputetë, jemi në vazhdim të seancës. Tash në qoftë se bëjmë vetëm pauza, në fund të fundit deputetët e vendosni me votim, sido që të vendosni kjo do të jetë vendimi juaj. Është ai propozim të cilin e dha Memli Krasniqi.

Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Janë të gjitha pikat me shmangie, do të thotë ta keni parasysh jemi duke votuar.

61 deputetë kanë votuar, 61 për, 1 abstenim. Kalon në tërësi propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi. Seanca e re fillon me rrjedhën në bazën të asaj të cilën e ka lexuar Memli Krasniqi.

Zoti Pajaziti e ka kërkuar fjalën për çështje të cilat kanë të bëjnë me një emergjencë nacionale. Të paktën kështu ka kërkuar që nuk lidhet me këtë pikë të rendit të ditës. Po urdhëro zoti Pajaziti të jemi edhe ne në rrjedha, jemi deputetë.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Kolegë deputetë,

Kabinet i Qeverisë,

Meqenëse u dakorduam për këtë rend dite dhe se kemi mundësi në atë pjesën e parë, po e shfrytëzoj rastin edhe prezencë e Qeverisë këtu, para pak çastesh në Gjilan ka ndodhur një aksident me përmasa tragjike, ka edhe të vdekur edhe shumë të lënduar, edhe nuk e di nëse Komuna e Gjilanit ka kapacitete këtë emergjencë ta menaxhojë tash për tash në kushtet që i ka. E ftoj kryeministrin me dikasterin e shëndetësisë të punëve të brendshme që t'i dalë në ndihmë sa më shpejt Komunës së Gjilanit, në mënyrë që të tejkalohet sa më shpejt ky rast, kjo emergjencë.

Edhe po ashtu i kërkojmë që jemi pranë familjarëve dhe të gjithë atyre që kanë humbur në këtë tragjedi dhe do t'u dalim në mbështetje të gjithë me sa mundësi që kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Pajaziti! Kryeministri vetëm ka reaguar. Urdhëroni fjalën, i nderuar kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit zoti deputet, pra për shqetësimin tuaj edhe të gjithë qytetarëve të Gjilanit, por edhe të gjithë Kosovës dhe të gjithë të tjerëve e ndajmë.

Pra, është në të vërtetë shqetësuese, se është një aksident me përmasa të mëdha, ka të vdekur, ka të lënduar. Jam dëgjuar më herët me kryetarin e Gjilanit, z. Haziri, e pra mekanizmat komunalë janë veprues. Kemi biseduar me gjithë nivelin nacional, përfshirë edhe inteligjencën, edhe sigurinë, edhe emergjencat, edhe njësitë shëndetësore. Situata pra sigurt ju them është nën kontroll, pra është në menaxhim dhe do të vazhdojmë të jemi afër, ta përcjellin nga afër këtë gjendje. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! E falënderoj deputetin, edhe kryeministrin, që t'ju qëndrojmë pranë qytetarëve tanë. Shpresojmë që do të jetë me sa më pak pasoja. Tash pa u konstatuar, nuk na lejohet as moralisht të marrim ndonjë veprim brenda seancës, ta kemi parasysh. Kjo është pse nuk shkoj më tutje. Dhashtë Zoti të ketë sa më pak njerëz të familjeve tona të cilat kanë pësuar.

Po kthehem prapë në pikën e rendit të ditës, e cila është aprovuar me shumicën absolute të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

### **1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj nënkryetarin e Komisionit për Punë të Jashtme, zonja Time Kadrijaj, për arsyetimin e raportit.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Komisioni në mbledhjen e mbajtur me 25 shkurt e ka shqyrtuar Projektligjin, ndërsa në mbledhjen e mbajtur më 6. 3. 2019, i shqyrtoi dhe i miratoi amendamentet e deputetit Gorani në Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.



Në raportin e Komisionit, i cili është përcjellë sipas procedurës, komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin në fjalë, është shqyrtuar nga të gjitha komisionet e tjera dhe prapë është sjellë në Komisionin parlamentar për punë të jashtme.

Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 7 mars 2019, miratoi raportin me rekomandime në këtë Projektligj dhe i propozon Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e tij. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në këtë Projektligj janë propozuar dy amendamente nga deputeti Dukagjin Gorani edhe pastaj Ilir Deda e riaktualizon kërkesën të cilën e pati. Më vonë, po.

Amendamenti 1 dhe amendamenti 2. Të dy amendamentet janë në përkrahje nga komisioni funksional. I vëmë në mënyrë elektronike të dyja në votim përnjëherë. D.m.th. janë me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamentet e propozuara nga deputeti Dukagjin Gorani. Votojmë tash!

Votimi është ky i cili është. Nuk ka marrë numrin e nevojshëm. Ta përsëritim, në bazë të rregullit. Shkojmë edhe një herë në mënyrë elektronike. Në qoftë se nuk funksionon, pastaj ju lutem me ngritje dore. Menjëherë e konstatoj. Ju e dini, është rregulli që momentin kur ka ngritje me dorë, për arsye se s'po e dimë a po punon teknika apo jo, atëherë administrata, regjia na e jep rezultatin dhe unë e konstatoj përfundimisht vetëm pas atij rasti është legjitim.

Shkojmë edhe një herë në votimin e njëjtë. Për dy amendamentet e propozuara. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 60 për, 2 abstenime. Kalojnë dy amendamentet e propozuara.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Përgatitemi për votim, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 58 për, 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

***2. Votimi i Platformës për Dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë***

Jemi në votimin e platformës, debati ka përfunduar.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

70 deputetë janë në sallë, 57 kanë votuar, nuk kam çfarë të konstatoj.

Shkojmë prapë në votim, jemi te platforma. Platforma ka edhe lobime pozitive dhe opozitive, janë legjitime.

Të keni parasysh, duhet të kalojë me 61, po, jo, duhet të kalojë për t'u konstatuar vlefshmëria e një votimi, legjitimiteti dhe legaliteti, besa.

Përgatitemi për votim, votojmë tash!

58 deputetë, nuk kalon. Jemi në proces të votimit.

Urdhëro, zoti Molliqaj, fjala për ju!

**DARDAN MOLLIQAJ:** Faleminderit!

Kërkoj falje, ndoshta është në kundërshtim me procedurat. Ne tre deputetë të Partisë Social Demokratike nuk jemi duke votuar, nëse platforma nuk i ka 61 vota për, Partia Socialdemokrate nuk e voton. Pra, partnerët e tjerë që janë pjesë e delegacionit duhet të sigurohemi që i kemi të gjitha votat për.

Një platformë, e cila nuk i merr 61 vota, për ne nuk është e pranueshme, kështu që i ftoj partnerët e koalicionit që janë andej, që jemi në këtë çështje, të mblidhen me deputetë dhe të diskutojnë.

Nëse nuk i kemi 61 vota për, ne nuk votojmë. Kërkoj falje, po s'ka kuptim platformë pa 61 vota për.

**KRYETARI:** Ky është qëndrim politik, po megjithatë jemi në seancë.

Të keni parasysh, shkojmë edhe një herë në votim, për faktin se unë dua të marr një pauzë për përgatitjen e renditjes nga regjia, të asaj çfarë e ka radhitur propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, Memli Krasniqi, për faktin se...

*(Ndërhyrje)*

Jo, edhe një herë, po sa të dëshirojnë deputetët, deri sa t'i marrë 61 vota, në momentin që i merr 61 vota, ajo merr fund.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Prapë janë 59 deputetë.

Ju kisha lutur për mirëkuptim.

I duhet regjisë, ka kërkuar prej fillimit 15 minuta pauzë që ta sjellë radhitjen e rendit të ditës, do të thotë vazhdojmë pas 15 minutave.

\* \* \*

**KRYETARI:** Ju kisha lutur, kolegë deputetë, zini vendet! Tanimë po shihet që 61 deputetë janë sigurisht në sallë, s'kam nevojë të kërkoj prezencën fare.

Nënkryetar i Kuvendit, derisa të uleni, pak më herët zoti Kujtim Shala e ngriti një çështje, e cila ka të bëjë me procedurat, për sqarim të opinionit. Proceduralisht, unë po e them disa herë, nuk lejoj të bëhet një proces i votimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilin e di që është kundër Rregullores dhe gabim, kjo është arsyeja i procedimit të mëhershëm dhe mbylljes së seancës, vetëm ta qartësoj, për vetë faktin se kalimi i pikës së parë, në formën që nuk ka mundur të kalojë, pastaj të shkoja unë me pikën e dytë, të votoja dhe të bëja shkelje të qëllimshme, e konsideroj se është një gabim i vetëdijshëm nga ana ime, për ta futur në lajthitje edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo është arsyeja, ta qartësoj edhe publikisht, pse as nuk lejoj as nuk do të lejoj. E vetmja shkelje çka do ta lejoj edhe në vazhdimësi është qytetarët e vendit ju kanë sjellë në Kuvend dhe unë s'kam të drejtë fort t'jua ndal fjalën, veç kur e teproni shumë, kur shihet ashiqare që po abuzoni me foltoren.

Po, urdhëro nënkryetar! Për qartësim të deputetëve, regjia, bini ziles, të lutem, nënkryetari i Kuvendit, zoti Kujtim Shala, e ka fjalën.

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, tani unë po e përsëris për të gjithë, meqë pretendimet e mia dhe komunikimi im ka qenë drejtpërdrejt vetëm me kryetarin e Kuvendit. Unë mendoj që sot ka pasur disa shkelje, jo vetëm kjo, për të cilën po flet kryetari i Kuvendit.

E para, Kuvendi nuk ka pranuar ta trajtojë si çështje urgjente atë çështje, të cilën e ka parë si urgjente Kryeministri i Republikës së Kosovës. Mbi këtë bazë, ne s'do duhej të fillonim fare punimet.

E dyta, nëse diskutohet, nëse debatohet, i bie që seanca po zhvillon punime, po mban punime. Nëse diskutohet, seanca nuk mund të mbyllet pa proces deklarimi, domethënë pa vendimmarrje. Kjo nënkupton që deputetët duhet të votojnë për ose kundër. Nëse s'ka kuorum, seanca nuk mund të ndërpritet, s'mund të mbyllet ashtu qysh e mbylli kryetari i Kuvendit, duhet të ndërpritet dhe mbetet e hapur. Tani, çfarë ka ndodhur këtu, në një seancë, e cila ka qenë totalisht e parregullt, e cila është zhvilluar në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, ka pasur dy pika të rendit të ditës, e që përbëjnë një çështje të vetme, i ka marrë një seancë tjetër me një mocion procedural. Domethënë, pengesa është kjo, seanca është mbyllur pa të drejtë, kryetari ose kushdo që e drejton seancën s'ka të drejtë ta bëjë këtë, nuk mund të mbyllet seanca pa votim.

Çështja tjetër, s'mund të fillohet seanca e re pa u njoftuar zyrtarisht me shkrim deputetët, sepse s'e dimë kur do të fillojë. Po të fillonte në orën 10:00 dhe deputetët s'vijne, atëherë do të ishim në rregull. Domethënë, këto janë pretendimet e mia që t'i keni të qarta të gjithë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nënkryetar, po kam dëshirë të jemi transparent për çdo gjë çka bëjmë këtu, tek e fundit, unë jam kryetar i zgjedhur, po kjo ishte edhe për respektin ndaj pozicionit të nënkryetarëve pse e bëra publike e s'desha ta mbaj vetëm komunikim mes nesh. Edhe një herë, sa për qartësim të opinionit publik, çështja e emergjencës është qartësuar nga aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese, në shkurt të vitit 2018, me kërkesën e zotit Glauk Konjufca, ku qartësohet në mënyrë fare të qartë se kryeministri mund të thërrasë për çfarëdo çështje seancë të jashtëzakonshme. Referohuni ju kërkesës së Glauk Konjufcës, pikërisht kjo ndërlihet me pretendimin tuaj të parë, për atë arsye po dua t'i referohem edhe për publik, edhe për qytetarë, por edhe për media, për secilin.

Nën dy, mocioni për plotësim të rendit të ditës ka kaluar me më shumë se 2/3 e votave, 62 kanë qenë prezencë, 62 kanë votuar për. Pjesa e dytë, pse u mbyll? Nuk lejoj që të bëhen gabime, të cilat krijojnë precedent nga unë si kryetar i Kuvendit ose nga kushdo qoftë që jam në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit.

Pjesa e tretë, kemi raste më shumë nga mandati im si kryetar i Kuvendit, kur jemi në seancë, është e vetëkuptueshme, deputetët duhet të jenë aty, edhe kjo është vetëm vazhdim i seancës. Në qoftë se dëshirojnë deputetët, nëse kërkojnë, administrata u sjellë precedente më shumë se sa dyshifrore kur kemi bërë edhe mandatin e kaluar, edhe tani, ju sjell në qoftë se dëshironi.

Po vazhdojmë, jemi në votim të Platformës për Dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare gjithëpërfshirëse, nënkryetari, prapë, jo të lutem s'ka kurrëgjë. Ka të drejtë njëjtë si unë, urdhëro nënkryetar.

Deputetët është dashur të jenë në Kuvend, kjo është përgjegjësia e deputetit të jetë në sallë të Kuvendit, megjithatë urdhëro, nënkryetar, për respekt dhe me fjalën e nënkryetarit unë më s'reagoj, vazhdoj seancën.

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Unë besoj që në këtë fjalën tuaj të dytë për herë të dytë ju e dëshmuat më qartë se sa herën e parë që ka pasur disa shkelje.

**KRYETARI:** Po vazhdojmë:

*2. Votimi i Platformës për Dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë*

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Janë edhe tre kolegë me dorë, regjia të lutem, Dardan Molliqaj, Shqipe Pantina, Aida Dërguti, më lejoni edhe një herë, regjia, po elektronike janë.

59 deputetë në mënyrë elektronike, 3 me dorë, bëjnë 62, cila është vota juaj tre deputetë? Për! 58 deputetë në mënyrë elektronike për, 3 me dorë 61. Një abstenim.

Ky është rezultati i votimit, të cilin unë do ta konstatoj pasi të konstatohet prezenca e votimit në mënyrë elektronike, i përmenda për protokoll, edhe me dorë tre deputetë, atëherë e konstatoj saktësisht kur të ma sjellë edhe një herë regjia votimin.

E vazhdojmë seancën, nuk po e mbyll konstatimin, po them publikisht e konstatoj pasi të shihet saktësisht rregullshmëria e votimit.

*3. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës*

Diskutimet janë kryer. Vazhdojmë me amende votimin e amendamenteve janë gjithsej amendamente 25. Të gjitha në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Në qoftë se nuk ka vërejtje nga dikush prej deputetëve, i votojmë të gjitha bashkërisht në paketë në mënyrë elektronike.

Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë 25 amendamente bashkë. Votojmë tash!

Kemi probleme me teknikë. Një lajm shumë të mirë. OSBE do të ndihmojë Kuvendin e Republikës së Kosovës me rreth 650 mijë euro, mbështetje veç në mënyrë elektronike, përfshirë këtë investimin e votimit. E falënderojmë edhe publikisht.

Përgatitemi edhe një herë për votim. Regjia, a mund të përgatitemi teknikisht? Përgatitemi për votim, votojmë tash, 25 amendamentet. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, edhe kanë votuar për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me të gjitha amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

#### ***4. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit***

Diskutimet janë kryer. Vazhdojmë me votimin e amendamentit. Një amendament. Në mënyrë elektronike, votojmë tash.

61 deputetë, 61 deputetë për.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Faleminderit! Urime të gjithë sportistëve dhe klubeve.

61 deputetë kanë votuar, 61 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-090 për Sponsorizime në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

**5. *Votimi në lexim të dytë i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075***

Në këtë projektligj janë propozuar vetëm tre amendamente, pasi debati është kryer.

Vazhdojmë me votimin e tri amendamenteve bashkërisht me përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

61 deputetë, 61 kanë votuar për. Miratohen amendamentet e propozuara.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Siç duket prapë probleme, ju lutem vetëm një pritje. Regjia, a jemi gati? Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 Ligji i sportit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-075.

**6. *Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive***

Diskutimet janë kryer. Janë dy amendamente. Të dyja në përkrahje të Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 60 për, 1 abstenim.

Miratohen amendamentet e propozuara.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 52 për, 9 kundër.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive.

## **7. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës**

Në këtë Projektligj janë propozuar gjithsej 32 amendamente. Unë do të shkoj, do t'i, në qoftë se ka mundësi vëmendjen e juaj, edhe për mua, për herë të parë i lexoj. Ato që janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONal, i vendosi të gjitha bashkërisht përnjëherë në votim.

Vëmendje, amendamenti 1, amendamenti 3, amendamenti 4, amendamenti 6, amendamenti 8, amendamenti 10, amendamenti 13, amendamenti 15. Amendamenti 14 është propozim i deputetes Albulena Haxhiu me përkrahjen e Komisionit FunkSIONal. E la, nuk futet 14-shi ta keni parasysh njëherë. Amendamenti 16, amendamenti 18. Do të shkoj vetë këto në përkrahje të Komisionit FunkSIONal. Amendamenti 20, amendamenti 21, të cilat janë vetëm pa propozimin e askujt, amendamenti 23, amendamenti 24, amendamenti 25, amendamenti 28 deri në 33, bashkërisht, 28, 29, 30, 31, 32, 33.

I votojmë njëherë vetëm këto amendamente këto amendamente në mënyrë elektronike bashkërisht.

Votojmë me përkrahje të Komisionit FunkSIONal. Votojmë tash!

60 deputetë në mënyrë elektronike, 1 me dorë, 61. 58 në mënyrë elektronike për, plus 1 me dorë, 59 për. 2 abstenime. Kalojnë të gjitha amendamentet e lartpërmendura.

Tash unë do t'i fus amendamentet të cilat janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONal dhe të propozuara nga kushdo që është. Vëmendje, amendamenti 2 është nga Albulena Haxhiu me përkrahje të Komisionit FunkSIONal, amendamenti 7 nga Albulena Haxhiu me përkrahje të Komisionit FunkSIONal, amendamenti 14 nga Albulena Haxhiu me përkrahje të Komisionit FunkSIONal, amendamenti 17 nga Albulena Haxhiu me përkrahje të Komisionit FunkSIONal, amendamenti 19 Komisioni për Buxhet dhe Financa me përkrahje të Komisionit FunkSIONal. Këto janë, vëmendje ju lutem! Vetëm këto janë.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Janë propozime të deputetëve ose kishte Komisioni për Buxhet dhe Financa me përkrahje të Komisionit FunkSIONal. Vota është e juaja, votojmë tash!

Ju kisha lutur të nderuar kolegë deputetë, në qoftë se nuk kalojnë amendamentet, Ligji nuk kalon. Votoni për ose kundër! Janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONal.

Jemi në Projektligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Janë në përkrahje të Komisionit FunkSIONal. Hajdar Beqa, urdhëro!



HAJDAR BEQA: Kryetar, faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, e ka shqyrtuar do të thotë edhe në grup punues, por edhe në Komision dhe e ka propozuar raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial dhe amendamentet e grupit punues e kanë marrë përkrahjen e Komisionit, por edhe amendamentet e deputetëve të cilët e kanë marrë përkrahjen e Komisionit, pavarësisht kush janë deputetët që kanë propozuar, kërkoj nga deputetët që t'i përkrahim, është në interes edhe të ligjit. Faleminderit! Janë në harmonizim edhe me sponsorizuesin e ligjit, që ka qenë pjesë e grupit punues.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi qartësim edhe nga Komisioni për Legjislacion.

Shkojmë në votim. Votojmë të gjitha bashkërisht. Votojmë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL veç amendamentet e propozuara nga deputetja dhe Komisioni. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 49 për, 7 kundër, 6 abstenime. Kalojnë këto amendamente.

Vëmendja juaj. Tani jemi te amendamentet pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL të propozuara nga kushdo, unë i përmendi.

Amendamenti 5 Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 11 Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 12 Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 22 Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 26 Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Shkojmë në votim, Lista serbe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamentet e propozuara. Votojmë tash!

Shkojmë edhe një herë në votim. Janë amendamentet e propozuara nga Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

58 deputetë kanë votuar në mënyrë elektronike, 4 me dorë. 3 janë për, 49 plus 4 me dorë, 53 kundër, abstenim.

Nuk kalojnë amendamentet e propozuara.

Jemi në amendamentin 9. I kemi dy propozime. Propozimi a, shkojmë në mënyrë elektronike, apo me dorë, pasi janë i dy propozime. Shumë maltretim. Po e shoh, shkojmë me dorë.

Kush është për variantin A, propozim i Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër veç? A ka abstenim. Të gjithë jemi për prezent. Prezencën ma jep të lutem! E kemi, amendamentin 9, propozimi, sa deputetë janë në sallë? 68. Do të thotë shkojmë te varianti B, i cili është vetëm pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, zonja Albulena Haxhiu. Kush është për të Albulena Haxhiut, a ka abstenim. Të gjithë janë kundër, 68 deputetë. Atëherë deklarohuni zonja deputete se s'jam unë evlia ta dijë. Cila është vota juaj, të lutem! Mos e maltretoni seancën. Votoje edhe një herë e votoj. Është propozimi i amendamentit 9. Kush është për, është propozimi i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Kush është për, a ka ndonjë për? 68 deputetë janë në sallë. Kush është abstenim? A mund ta konstatoj të gjithë janë kundër. A ka mundësi pra kush është kundër pra veç me dorë? Shumica absolute është kundër, do të thotë edhe një herë për korrektësi. Ju mund të votoni si të doni. Unë kthehem nëse doni të votoni edhe në mënyrë elektronike, por mos maltretoni seancën.

Amendamenti 27, propozim i deputetit Hajdar Beqa me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Nën a, a ka dikush kundër? Kundër? Mbaje regjia, 68 deputetë janë kundër. Edhe unë Hajdar jam kundër, qe. A ka abstenim? Një abstenim, dy, tre, katër, të tjerët janë për. Atëherë e konstatoj 68 i largoni kundër abstenimit edhe për.

Shkojmë te amendamenti i propozuar nga Fitore Pacolli, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është për, edhe unë jam për. 2. A ka abstenim? Të gjithë janë kundër. Atëherë, kalon me 59 vota për, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, pjesa tjetër ishin 9 kundër.

Propozimi i Hajdar Beqës A, cili është tjetër? Propozimi i Hajdar Beqës me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, me 59 vota për, 9 kundër.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë në mënyrë elektronike tash. Votojmë tash!

Ka problem edhe në mënyrë elektronike, për arsye se në ekranin tim kalon votimi, është në progres edhe dy sekonda të mbetura.

Votojmë edhe një herë. Edhe kështu në bazë të kësaj s'mund ta konstatoj po, janë 57. Edhe një herë, jemi në votimin e tekstit të Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Janë 59 deputetë kanë votuar, nuk janë 61. E vendosim edhe një herë në votim. Me dorë varet prej juve. Nëse ka reagim, unë s'fitem me dorë. A ka reagime për të votuar me dorë? Prania ju lutem, për arsye se s'ka reagime. Prania pra në sallë. Ju kisha lutur, si dëshironi? Disa po thonë me dorë...

A shkojmë me dorë? Disa po thonë me dorë. Do të votojmë me ngritje dore, në sallë janë 66 deputetë. Kush është për ligjin, kundër? Kush është kundër? 66 deputetë janë prezentë. A ka abstenim? A mund ta konstatojmë? 66 deputetë janë për. Jo! Atëherë me ngritje dore kush është për?

*(Ndërprerje e incizimit)*

61 janë për, me votën e Naitit, ta keni parasysh. Vota e Naitit kundër. Pra, Naiti ishte kundër. Do të thotë 60 për dhe 1 kundër. 61 deputetë kanë votuar.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Votimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit...Zonja Ganimete e ka fjalën. Ganimete Musliu e ka fjalën. Urdhëroni zonja Ganimete! Kemi problem me elektronike, po ju them seriozisht.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Pikërisht është ky problemi, sepse pak më herët e votuam propozimin e Listë Serbe pa përkrahje të Komisionit Funkcional. Vota ime është kundër, ndërsa këtu është regjistruar për. Dua ta deklaroj publikisht për shkak të opinionit në mënyrë që nesër ose pasnesër të mos keqkuptohet. Vota ime është kundër atij amendamenti edhe pse këtu është regjistruar për. Faleminderit!

KRYETARI: Na kanë ndodhur raste të tilla gabimisht, por megjithatë është mirë që e bërë publikisht, sepse kjo është gabimisht, po atje regjistrohet. Si do që të jetë duhet...Urdhëro?! Tri vota. Dëgjo, kur bëni gabime të tilla. Më falni! Është mirë t'ia bashkëngjitni një deklaratë me shkrim arkivit të votimit.

Ju lutem, ia bashkëngjitni arkivit të votimit, keni parasysh.

#### ***8. Votimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore***

Vazhdojmë me votimin për emërimin e anëtarëve të Komisionit për ndihmë Shtetërore në këtë përbërje: Fortuna Shaqiri-Haxhikadrijaj, Alban Elshani, Mehmet Krasniqi, Bashkim Mustafa dhe Asdren Osaj.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash. 61 deputetë kanë votuar. 48 për, 6 kundër, 7 abstenime.

Kuvendi i emëroi edhe 5 anëtarët e Komisionit për Ndihmë Shtetërore me mandat 3-vjeçar.

## ***9. Votimi për emërimin e kryesuesit dhe të një (1) anëtari të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit***

Vazhdojmë me votim për emërimin e kryesuesit dhe 1 anëtari të Bordit për Agjencinë Kosovare të privatizimit si në vijim: Bajram Zejnullahu, kryesues; Hajzer Salihu, anëtar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

Kanë votuar 59 deputetë. A të shkojmë me dorë? Si të doni ju. Shkojmë edhe njëherë në mënyrë elektronike. Po, e dini ju se kush është në pyetje. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

Megjithatë e kemi një reagim, sepse Islam Pacolli nuk qenka... Vetëm kërkoj falje, se paska kërkuar te administrata...Nuk ka votim. Shkojmë në mënyrë elektronike po s'qenka Islam Pacolli. Është Bajram Zejnullahu, vëllai i heroit Hakif Zejnullahu dhe Hajzer Salihu. Jemi në proces të votimit.

Po shkojmë në votim me dorë. A po shkoni me ngritje apo me votim elektronik? LDK-ja plus. Me dorë? Shkojmë në votim me dorë. Përgatitemi për votim. 67 deputetë janë sallë. Votohet për Bajram Zejnullahun dhe Hajzer Salihun. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash. Më falni! Me dorë, kërkoj falje sepse ngarkesa është pyetje. Ju kërkoj falje dhe juve.

Kush është kundër? A ka abstenim? Kush është për? Ngriheni dorën ju lutem. Vetëm edhe pak. Administrata është lodhur. Arben a ishte vota për, ngase po thonë...Po, për atë arsye, se e pash reagimin tuaj dhe të Naserit. Naser, a ishte edhe vota juaj për? Për atë arsye, se po i shoh...

Edhe njëherë, unë po i numëroj votat për, ama ju kisha lutur për vëmendje ju lutem.

A ka mundësi me ngritje dore edhe njëherë, kush është për? Është në rregull pozicioni ku është derisa nuk futet, po edhe sikur të futet brenda nuk është asgjë. Si do që të jetë, shkojmë edhe njëherë ngase po e shoh që kemi shumë probleme.

I kisha lutur deputetët që votojmë në mënyrë elektronike edhe njëherë, për arsye sepse nuk po mund ta arrijmë kuorumin e votave dhe administrata po e ka problem që t'i numërojë. Është pak edhe për respekt ndaj tyre. Votojmë në mënyrë elektronike, votojmë tash për të njëjtin propozim.

Ky është votimi ashtu siç është. Shkojmë në pikën e radhës. Mund ta vë edhe njëherë në votim po në fund.

Tek votimi i platformës që të jem korrekt, është vërtetuar se tre deputetët që kanë votuar me dorë, nuk kanë votuar në mënyrë elektronike. Do të thotë kalon me 61 vota. Konstatimi është përfundimtar për, është fjala për platformën. Ta kemi parasys.

#### ***10. Votimi për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala***

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare të cilat nuk i kanë dërguar propozimet për këtë komision që sot t'i propozojnë deputetët për kryesues, zëvendëskryesues dhe anëtarë të Komisionit Hetimor Parlamentar.

Grupet parlamentare opozitare nuk e kanë propozuar kryesuesin e komisionit hetimor, gjithashtu as zëvendëskryesuesin. Nuk është propozuar nga iniciatori i komisionit hetimor.

Grupi Parlamentar i LDK-së i ka propozuar Armend Zemajn dhe Haxhi Avdylin anëtarë. Grupi Parlamentar i PDK-së, Bekim Haxhiun dhe Belerat Deliu-Kodra anëtare. Lëvizja Vetëvendosje, Lirburn Aliun dhe Albulena Haxhiun. AAK-ja, Shkumbin Demalijaj. PSD-ja, Visar Ymeri. Lista Serbe nuk ka propozuar. Nisma, Milam Zekën. 6+ a ka mundësi ta marrim propozimin. Zoti Albert, urdhëro!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar 6+ propozon deputetin Fikrim Damka. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, këta janë të propozuarit.

Milaim Zeka, deputeti duhet ta propozojë një kryesues për faktin se nuk kemi. Nuk mund të jeni. Urdhëroni, Milaim Zeka!

MILAIM ZEKA: Unë do ta propozoja meqë është i akuzuar, ashtu-kështu i akuzuar, Shkumbinin. Edhe jemi bashkë të akuzuar zoti kryetar.

KRYETARI: Zotëri Zeka që t'ju ndihmoj. Mos e mbyllni. Nuk keni të drejtë që të propozoni nga grupi parlamentar i cili është iniciator i komisionit hetimor dhe nuk i përket partisë së koalicionit qeverisës. Do të thotë këta nuk duhet të jenë.

MILAIM ZEKA: Atëherë, më të mirë se Visarin nuk gjej, ngase sikur të ishte Dardani, ai do të merret vesh dhe na nxjerr probleme. Kështu që unë e propozoj Visarin.

KRYETARI: Visar Ymerin, a po?

MILAIM ZEKA: Visar Ymerin, po.

KRYETARI: Atëherë, a shkojmë në votim? Votojmë këtë që e lexova. Me propozimin e deputetit Milaim Zeka, kryesues i komisionit. Votojmë me dorë? Si nuk ka reagim, çdoherë shkojmë me dorë. Sa deputetë janë në sallë, ta marr vesh? 62 deputetë janë në sallë, atëherë shkojmë në votim. A është dikush kundër?

Unë shkoj për, kur jemi me dorë në qoftë se është shumica. A ka ndonjë abstenim? Të gjithë janë për.

Kërkohet nga Komisioni Hetimor Parlamentar që të veprojë në përputhje me Ligjin për hetim parlamentar dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime në afatin prej 1 muaji nga data e formimit.

#### *9. Votimi për emërimin e kryesuesit dhe të një (1) anëtari të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit*

Votimi edhe një herë për emërimin e kryesuesit dhe të një (1) anëtari të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Është votimi për Bajram Zejnullahun kryesues, dhe Hajzer Salihun. A votojmë me dorë? Kush është kundër? Vetëm ngrehni dorën ju lutem. 12 kundër. A ka abstenim? 1 abstenim. 2 abstenime. 3 abstenime.

A mund ta konsideroj pjesën tjetër që është për? Sa deputetë janë në sallë? 62 deputetë janë në sallë dhe me këto vota të konstatuara kemi: 12 kundër, 3 abstenime, pjesa tjetër për, 47 janë për, 3 abstenime 12 kundër.

Kuvendi e emëroi kryesuesin dhe një (1) anëtar të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam reagime nga deputetët, sot është Nata e Zjarreve. Po e vë edhe këtë pikë nga PSD-ja, pastaj për korrektësi ngase ka deputetët... Do ta jap mundësinë varet prej jush në seancë.

Unë nuk e mbyll derisa janë 61.

#### *11. Votimi i kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate*

Grupi Parlamentar i PSD-së i ka propozuar deputetit Faton Topallit për kryetar të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Marrëveshja ndërmjet Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe të PSD-së nuk është arritur për këtë çështje.

Procedojmë me votimin për emërimin e kryetarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë me deputetin Faton Topalli.

A jeni që të votojmë me dorë? Kush është kundër, veç? A ka kundër? 62 deputetë janë në sallë. 1 është kundër. A ka abstenim? E kemi 1 abstenim. 60 deputetë janë për. Kjo konstatohet. Me 60 deputetë për, 1 abstenim dhe 1 kundër, Kuvendi e emërori zotin Faton Topalli nga Grupi Parlamentar i PSD-së për kryetar të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Në bazë të Nenit 63 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i AAK-së ka marrë vendin për të bërë zëvendësimin në komisionet parlamentare si vijon: Anëtar në Komision për Punë të Brendshme në vend të deputetit Daut Haradinaj propozohet deputeti Labinot Tahiri. A është dikush kundër? 1 është kundër. 2 deputetë janë kundër. Atëherë 3 kundër. Labinot unë jam për së bashku me të gjithë të tjerët. Faleminderit! Është votim formal. Zonja deputete Teutë e ka fjalën, po kërkon para se të vazhdoj.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Së pari kërkoj mirëkuptimin e kolegëve deputetë. Në mënyrë që ta kemi edhe një pikë që është e renditur, por është më poshtë, Këshillin e Kosovës për Trashëgimi. Ka muaj të tërë që ky këshill nuk është votuar. Për hir të korrektësisë, këshilli nuk është funksional.

Kemi probleme shumë të mëdha mes këshillit edhe Ministrisë së Kulturës. Prandaj, sinqerisht është shumë e nevojshme që ta bëjmë funksional. Nuk mund ta kthejmë prapa, por është mirë që të kërkojmë që sot ta qesim në votim. Prandaj kryetar edhe juve po ju kërkoj edhe deputetëve që ta hedhim në votim dhe ose ta refuzojmë ose të votojmë për.

KRYETARI: Është pika 19, të cilën e ka kërkuar deputetja për sot.

### ***19. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore***

Kandidatët që duhet të votohen janë: Zanita Halimi, Premtim Alaj, Arjeta Miftari, Arsim Mehmeti, Muhamet Qerimi, Bege Kolulleri, Filko Jovanoviq. A jeni që ta fusim në votim dhe sa deputetë janë në sallë? 62 deputetë janë në sallë. Do të votojmë me dorë. Nisma po kërkon që votojmë në mënyrë elektronike me sa po e shoh. Shkojmë edhe në mënyrë elektronike.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. Emrat u përmenden, votojmë tash. Gani s'ke nevojë mundesh me dorë. Për a po? Po! Urdhëroni ju të tjerët, votoni në mënyrë elektronike. Edhe një herë do ta votojmë! 62 deputetë janë në sallë. Ju kisha lutur që të votoni në mënyrë elektronike, të paktën për ose kundër si të doni.

Votojmë edhe një herë, votojmë tash. A ka reagim me dorë nga Nisma? Regjia, prisni ju lutem! A të shkojmë me dorë? Nisma nuk pranon. Numëroni sa deputetë janë. Nëse nuk janë 61 deputetë, atëherë nuk futemi në votim fare, nuk kemi pse votojmë kotë.

Kanë dalë 2 deputetë jashtë salle, ta keni parasysh, përkatësisht 3. Aktualisht jemi 59. A kthehen apo nuk kthehen... Po e shoh që po largohet edhe i 4-ti. Me kaq kjo seancë mbyllet në këtë rast. Vazhdojmë, do të t'ju thërrasim, seanca është e hapur për këto pika të rendit të ditës. Në momentin kur e shohim të arsyeshme do t'i konsultojmë kryetarët e grupeve parlamentare për vazhdimin e kësaj seance. Faleminderit për mirëkuptim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*